

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PARTNER I RËNDËSISHËM I FINANCAVE PUBLIKE

*(Institucionet Supreme të Auditimit,
partnerë të rëndësishëm në planifikimin dhe zbatimin e një buxheti të besueshëm.
Qasja këshillimore e Kontrollit të Lartë të Shtetit)*

*nga Luljeta NANO - Sekretare e Përgjithshme,
botuar në gazetën "Telegraf", më 02 qershor 2015.*



Nëse do ti referoheshin përkufizimit semplist të përcaktimit të një buxheti kredibël, të besueshëm do të thonim se buxhet i besueshëm është ai i cili ekzekutohet sikurse është planifikuar.

Por në një këndvështrim më të gjerë një buxhet është i besueshëm kur publiku është i bindur që buxheti bazohet në politika fiskale të shëndosha dhe të qëndrueshme, që mbështetet në objektiva fiskale afatmesme dhe shërben si një instrument efektiv për mbajtjen e qeverisë nën kontroll. Në këtë aspekt është e nevojshme që ekzekutivi të ndërmarrë më shumë qasje

proaktive për të adresuar në terma afatgjata nevojat e shoqërisë, konsideruar si një komponent kyç për besimin e publikut ndaj institucioneve qeveritare.

Por çfarë e bën një buxhet të besueshëm? Politikat duhet të hartohen bazuar në analiza të qenësishme. Udhërrëfyesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar sugjerojnë që parashikimet makro fiskale duhet ti nënshtrohen shqyrtimeve nga organizma dhe trupa të pavarura.

Referuar Strategjisë së Zgjerimit të BE-së, një ndër tre prioritetet bazike të strategjisë është qeverisja ekonomike dhe menaxhimi financiar publik. Një menaxhim kredibël dhe relevant i financave publike dhe i buxhetit të shtetit është faktor vendimtar për një qeverisje ekonomike të suksesshme.

Menaxhimi i Financave Publike (PFM) referuar strategjisë, përfshin angazhimin për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe të të gjithë procesit të buxhetimit nëpërmjet përgatitjes dhe implementimit të programeve (PFM) shumë vjeçare si dhe angazhimit në politikat dialoguese të PFM-së me Komisionin Europian.

KLSH në konvergjencë të plotë me objektivat e strategjisë së zgjerimit të BE-së dhe në një linjë me prioritetet e reformave i ka prezantuar Kuvendit rekomandimet të cilat synojnë marrjen e masave për sigurimin e qendrueshmërisë, kredibilitetit të financave publike dhe konsolidimin e një kuadri, rregulli fiskal.

Për disa vite radhazi KLSH ka sjelle në vëmendje të Kuvendit, faktin se situatat buxhetore janë karakterizuar nga projeksione mjaft optimiste gjë e

cila ka sjelle krijimin e një hendeku të thellë midis targeteve të planifikuara me ato të realizuara dhe që në mënyrë të pashmangshme ka çuar në rishikimin e treguesve buxhetor gjatë ekzekutimit të buxhetit, gjë e cila është shoqëruar me reduktimin e shpenzimeve buxhetore me impakte negative të drejtpërdrejta në ruajtjen dhe mbajtjen e një disipline fiskale efektive.

Një mënyrë e tillë e planifikimit të buxhetit me shkurtime dhe reduktime eventuale ka ndikuar në kah negativ jo vetëm menaxhimin e shpenzimeve publike (krijimi i borxheve të prapambetura, etj.) por nga ana tjetër ka cënuar rëndë edhe proceset e planifikimit të buxheteve në terma afatmesëm. Ishte Kontrolli i Shtetit i cili që për tre vite radhazi 2012, 2013, 2014 i adresoi Kuvendit rrezikun e krijimit të gropës së zezë buxhetore atë të krijimit të detyrimeve dhe borxheve ndaj biznesit si rezultat i ndërmarjes së angazhimeve kontraktuale përtej burimeve financiare disponibel, si dhe rekomandimet për përmirëzimin e gjendjes.

KLSH në funksion të promovimit të një qëndrueshmërie dhe kredibiliteti të financave publike dhe në funksion të përmirësimit të planifikimit të performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore, ka rekomanduar ngritjen e *një Këshilli Fiskal i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur, dhe që duhet të ketë një pavarësi operationale shumë strikte e rigoroze nga politika.*

Ky organizëm i pavarur do të shërbejë për të promovuar politika fiskale të qëndrueshme dhe efektive dhe duhet të jetë parakusht, që të karakterizohet nga një pavarësi nga qeveria dhe një transparence komunikimi të drejtpërdrejtë me median.

Ngritja dhe funksionimi i një Këshilli Fiskal i paanshëm, independent, dhe thellësisht teknik është mjaft i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe promovimin e qëndrueshmërisë së financave publike.

Ky rekomandim i Kontrollit të Lartë të Shtetit është në konvergjencë të plotë me orientimet e Bashkimit European dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Fiskale si institucione publike të pavarura por jo vetëm; rekomandimi është në një linjë me praktikën e ndjekura nga shumë vende vitet e fundit të cilët kanë ngritur agjencitë e pavarura me synim promovimin e politikave fiskale dhe hartimin e buxheteve të besueshme. Në kushtet kur historikisht buxheti i shtetit në vite ka rezultuar jo kredibël, është emergjente kryerja e opionencave të politikave fiskale, pa ndikime të politikës dhe që të jenë thellësisht teknike dhe të pavarura. Nëse ky Këshill Fiskal do të ngrihej dhe ekzistonte vite më parë pa dyshim që do të shmangej fenomeni i krijimit të borxheve ndaj biznesit rrjedhojë e planifikimeve të buxheteve mjaft optimiste jo realiste.

Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë në një linjë edhe me Raportin e Progresit të Bashkimit European të Tetorit të vitit 2014 në të cilin theksohet që:

“Në tërësi, stabiliteti makroekonomik duhet të forcohet më tej, duke ulur borxhin publik në raport me PBB-në, ndërsa ruhet hapësira fiskale për investime publike të orientuara drejt rritjes ekonomike.

Konsolidimi fiskal, i fokusuar në të ardhura, filloi me buxhetin 2014, por duhet më shumë punë për t'i bërë financat publike të qëndrueshme. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të forcuar planifikimin dhe zbatimin e

politikave ekonomike, përfshi planifikimin buxhetor dhe menaxhimin financiar publik”.

Kredibiliteti i buxhetit është i kondicionuar edhe nga sanksionimi dhe vendosja e një rregulli fiskal/objektivave fiskale të shprehur qartë në drejtim të targetimit të treguesit të borxhit, deficitit garancive, etj.

Krahas sa më sipër KLSH referuar zhvillimeve ekonomike ndaj nivelit të borxhit publik dhe risqeve që ai mbart në situatën makroekonomike të vendit; Referuar faktit që ndryshimi i kuadrit rregullator të limitimit të borxhit publik ndaj PBB-së, legjitimon mungesën e një tavani për borxhin publik dhe riskun e rritjes së tij; Shqyrtimit të trajektores dhe dinamikës në rritje të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së si dhe në vijim të rekomandimeve të dhëna nga KLSH si në vitin 2012 dhe 2013, KLSH në Tetor 2014 i prezantoi Kuvendit rekomandimin për ndërmarrjen e të gjitha masave për hartimin e një kuadri, rregulli fiskal, i cili të synojë në reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik. Përgatitjen dhe paraqitjen e një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin 60 % arritjen e këtij niveli në terma afatgjatë.

Në përfundim theksojmë që Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucioni i përgjegjës i garantuar nga Kushtetuta dhe ligji i tij organik për realizimin e mbikëqyrjes dhe auditimin e buxhetit të shtetit do të vijojë të jetë një partner i rëndësishëm duke ofruar qasje këshillimore me impakt mirëqeverisjen e financave publike në vend.